



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr.6 Prot.

Tepelenë, më 28.05.2026

PROÇES – VERBAL

(I zbardhur nga origjinali)

Procesverbal i Mbledhjes së Këshillit Bashkiak Tepelenë, i mbajtur sot, më:

Data: 28.05.2026

Ora: 12:09

Vendi: Pallati i Kulturës Tepelenë (kati i dytë)

Mbledhja e Këshillit Bashkiak Tepelenë u thirr nga Kryetari i Këshillit, në bazë të Nenit 53, pika 3, gërma a, Pika 4 e Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, si dhe "Rregullores së funksionimit të Këshillit Bashkiak", me këtë:

Rend Dite:

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluara datë 29.04.2026.
3. Projektvendim: "Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Prill 2026".
4. Projektvendim: "Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Prill 2026".
5. Projektvendim: "Për miratimin e raportit për monitorimin e vlerësimin e buxhetit për periudhën 4 mujori i parë 2026"
6. Projektvendim: "Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 77, datë 22.11.2025, 'Për miratimin e buxhetit të vitit 2026'."
7. Projektvendim: "Për transferimin e aseteve të financuara nga AKUK dhe të realizuara nga Bashkia Tepelenë."



8. **Projektvendim:** “Për dhënien e ndihmës financiare për personat e dëmtuar nga zjarri dhe përmbytjet.”

9. **Projektvendim:** “Për shfuqizimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 11, datë 29.01.2026.”

10. Çështje të tjera.

11. Trajtimi i kërkesave të qytetarëve.

Kryetar i Këshillit Bashkiak Z. Arben Gumeni drejton mbledhjen.

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: Arben Gumeni, Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Besnik Maca, Marsela Balili, Matilda Çela, Latif Kacaj.

Marrin pjesë nga Administrata e Bashkisë: Spiro Kora, Roven Mullara, Festime Elezi, Pellumb Hoxha, ekspert i jashtëm z.Myzafer Lici

Kryetar i Këshillit Z. Arben Gumeni deklaron hapjen e mbledhjes, paraqet rendin e ditës.

Kryetari i Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e rendit të ditës.

Vota PRO: 12

Arben Gumeni, Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Besnik Maca, Marsela Balili, Matilda Çela, Latif Kacaj

Vota kundër: S’ka

Vota abstenim: S’ka

Pika e dytë e rendit të ditës: Miratimin e procesverbalit të mbledhjeve të kaluara datë 29.04.2026

Kryetari i Këshillit u drejton pyetje këshilltarëve, në lidhje me procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

Këshilltarët shprehin dakortësinë për përmbajtjen e procesverbalit.

Kryetari i Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Vota PRO :12 Arben Gumeni, Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Besnik Maca, Marsela Balili, Matilda Çela, Latif Kacaj

Vota kundër: S’ka

Vota abstenim: S’ka

Pika e tretë e rendit të ditës: “Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Prill 2026”

Kryetari i Këshillit deklaron shqyrtimin e projektvendimit.

Fjalën e mori Keshilltari Znj. Matilda Çela: Komisioni u mbledh dhe shqyrtoi materialin është e njëjta listë nuk ka ndryshime nga muaji i kaluar, listën e keni përpara, propozoj ta miratojme ndihmës ekonomike me fond 6% për muajin Prill 2026.

Kryetari i Këshillit: Ka pyetje? Jo

Kryetari i Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e këtij projektakti.

Vota PRO: 12 Arben Gumeni, Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Besnik Maca, Marsela Balili, Matilda Çela, Latif Kacaj

Vota kundër: S’ka

Vota abstenim: S’ka

Pika e katërt e rendit të ditës: “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Prill 2026”

Kryetari i Këshillit deklaron shqyrtimin e projektvendimit.

Fjalën e mori Keshilltari Znj. Matilda Çela; Komisioni u mbledh, dhe u njoh me materialin, situata financiare është e njëjte janë 92 familje nga 93 që ishin muajin e kaluar, vlera e lekëve ka kaluar dy familjeve që e kanë parë të arsyeshme administratoret për të kaluar këtë fond lekësh, listat i keni në material.

Kryetari i Këshillit: Ka pyetje? jo

Kryetari i Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e këtij projektvendimi.

Vota PRO: 12 Arben Gumeni, Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Besnik Maca, Marsela Balili, Matilda Çela, Latif Kacaj

Vota kundër: S’ka

Vota abstenim: S’ka

Pika e pestë e rendit të ditës: “Për miratimin e raportit për monitorimin e vlerësimit të buxhetit për periudhën 4 muajit të parë 2026”

Kryetari i Këshillit deklaron shqyrtimin e projektvendimit.

Fjalën e mori Drejtori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, z. Spiro Kora, i cili paraqiti raportin e monitorimit të buxhetit për periudhën 4-mujore të vitit 2026.

Treguesit kryesorë financiarë për këtë periudhë janë si më poshtë:

Buxheti total është realizuar në shumën 171,640 mijë lekë, nga 461,062 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 37.2%. Buxheti i pavarur është realizuar në shumën 149,985 mijë lekë, nga 418,054 mijë lekë të programuara, ose në masën 35.8%. Transferta e kushtëzuar është realizuar në shumën 21,656 mijë lekë, nga 43,007 mijë lekë të programuara, ose në masën 50%. Të ardhurat e veta janë realizuar në shumën 16,860 mijë lekë, nga 21,661 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 77.8%, ndërsa realizimi mbi baza vjetore është 25.9%.

Materiali i detajuar i raportit është vënë në dispozicion tuaj dhe gjatë kësaj periudhe është evidentuar ulje e detyrimeve të prapambetura. Gjithashtu, Bashkia Tepelenë vijon të ruajë statusin e saj në gjendje normale financiare.

Fjalën e mori këshilltari z. Ditar Hodaj: Cili institucion vërteton saktësinë e këtyre të dhënave?

Drejtori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, z. Spiro Kora, Të gjitha të dhënat e paraqitura në raport janë të certifikuara nga Dega e Thesarit, bazuar në akt-rakordimet 4-mujore dhe tabelat e treguesve financiarë, të gjitha informacionet janë të regjistruara dhe të verifikueshme në sistem.

Këshilltari z. Ditar Hodaj falënderoi për sqarimin.

Kryetari i Këshillit; Ka pyetje, ta hedhim në votim për miratimin projektvendimin.

Vota PRO: 12 Arben Gumeni, Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Besnik Maça, Marsela Balili, Matilda Çela, Latif Kacaj

Vota kundër: S'ka

Vota abstenim: S'ka

Pika e gjashtë e rendit të ditës: “Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 77, datë 22.11.2025, ‘Për miratimin e buxhetit të vitit 2026’.”

Fjalën e mori Drejtori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, z. Spiro Kora; Bazuar në analizën e hollësishme të treguesve fiskalë dhe financiarë të periudhës 4-mujore të vitit 2026, si dhe me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë fiskale dhe mbulimin e shpenzimeve prioritare gjatë vitit ushtrimor, propozohet miratimi i disa ndryshimeve në buxhetin e vitit 2026, të miratuar me Vendimin nr. 77, datë 22.11.2025. Këto ndryshime nuk prekin treguesit makro të buxhetit të miratuar për vitin 2026, si në zërin e të ardhurave ashtu edhe në atë të shpenzimeve. Ato kanë të bëjnë vetëm me rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve buxhetore dhe llogarive ekonomike, me qëllim garantimin e vazhdimësisë së veprimtarisë normale të Bashkisë, përmbushjen e nevojave prioritare dhe rritjen e eficiencës në përdorimin e fondeve buxhetore.

- Shtesa dhe pakësime fondesh midis programeve buxhetore dhe llogarive ekonomike;
- Rishpërndarje fondesh të kushtëzuara nga ndryshimet në strukturën organizative dhe në nivelin e pagave, sipas VKB-së përkatëse të miratuar nga Këshilli Bashkiak;
- Mbështetje financiare për aktivitete kulturore dhe artistike në territorin e Bashkisë Tepelenë.

Në kuadër të organizimit të aktiviteteve të “Javës së Ali Pashës”, propozohet shtesa e fondit në shumën 200,000 (dyqind mijë) lekë, duke e çuar mbështetjen financiare në shumën totale 800,000 (tetëqind mijë) lekë, sipas aktmarrëveshjes së lidhur me Këshillin e Qarkut me Nr 89 date 06.05.2026

- Miratimi i një fondi në shumën 300,000 (treqind mijë) lekë për organizimin e festimeve të 60-vjetorit të grupit polifonik “Bënça”.
- Miratimi i mbështetjes financiare për pjesën dramaturgjike “Kur mungon fjala ” në shumën 250,000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë.
- Miratimi I mbështetjes financiare për spektaklin me titull “Vere e Portokall” në shumën 1,000,000 (Njemilion) lekë

Fjalën e mori Kryetari i Këshillit, z. Arben Gumeni; Ka pyetje ose diskutime lidhur me projektvendimin?

Fjalën e mori këshilltari z. Latif Kacaj; Ne mbledhjen e kaluar ju thatë se niveli i pagave ishte rritur në përputhje me pozicionet e punës, na kane ardhur ankesa ankesa për disa punonjës pagat ishin ulur. Ne sektorin e Gjendjes Civile, paga e këtyre punonjësve është e deleguar dhe nuk financohet nga buxheti i Bashkisë.

Drejtori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, z. Spiro Kora; Pas miratimit të strukturës dhe nivelit të pagave, çështja është shqyrtuar më në detaje në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, ku është vlerësuar se trajtimi I pozicionit është bërë sipas nivelit të përcaktuar.

Këshilltari z. Latif Kacaj; Bëhet fjalë për një pagë të deleguar nga institucioni përgjegjës dhe jo nga Bashkia.

Z. Spiro Kora; Kjo çështje do të rishikohet përsëri, pasi është ende objekt diskutimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile për të përcaktuar klasifikimin dhe nivelin përkatës të pagës për këtë kategori punonjësish.

Kryetari i Këshillit: Ka pyetje? jo

Kryetari i Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e këtij projektvendimi.

Vota PRO: 12 Arben Gumeni, Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Besnik Maça, Marsela Balili, Matilda Çela, Latif Kacaj.

Vota kundër: Ska

Vota abstenim: ska

Pika e radhës e rendit të ditës: “Për transferimin e aseteve të financuara nga AKUK dhe të realizuara nga Bashkia Tepelenë”.

Kryetari i Këshillit; Ky material bën fjalë për transferimin e aseteve të përfunduara, të financuara nga Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës-Kanalizimeve (AKUK), në administrimin e subjektit përgjegjës.

Fjalën e mori kryetarja e Komisionit znj. Matilda Çela; Komisioni e ka shqyrtuar projektvendimin dhe diskutoi mbi disa problematika të evidentuara, propozoi që nga projektvendimi të veçohen investimet që lidhen me ujësjellësit e fshatrave Sinanaj, Peshtan, Mezhgoran, Nivicë dhe Rexhin, për të cilat kanë paqartësi lidhur me përfundimin e punimeve dhe marrjen në dorëzim të objekteve, projektvendimi duhet të përfshijë vetëm asetet për të cilat punimet kanë përfunduar dhe janë marrë në dorëzim sipas procedurave përkatëse.

Këshilltari z. Ditar Hodaj; Përpara miratimit të projektvendimit, do të ishte e nevojshme prania e përfaqësuesve të Ujësjiellës-Kanalizimeve Rajonale për të dhënë shpjegime mbi situatën e shërbimit dhe problematikat e evidentuara nga qytetarët, përfshirë edhe çështjen e tarifave të ujit.

Znj. Matilda Çela; Këshilli Bashkiak po shqyrton transferimin e aseteve dhe jo çështje që lidhen me administrimin e shërbimit. shqetësimin jone është nëse të gjitha objektet e përfshira në projektvendim janë marrë në dorëzim sipas procedurave ligjore dhe propozoj që një grup pune me pjesëmarrjen e anëtarëve të Këshillit të verifikonte gjendjen faktike të investimeve.

Fjalën e mori këshilltari z. Vladimir Bakiaj; Në mbledhje të ftoheshin përfaqësues të AKUK-së dhe të firmave zbatuese, së bashku me dokumentacionin teknik përkatës, me qëllim që Këshilli të informohej më qartë mbi përmbajtjen dhe realizimin e projekteve.

Drejtori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, z. Spiro Kora; Une ketu mund të flas vetëm aspektet financiare dhe procedurale të transferimit të aseteve, pasi nuk jam i autorizuar të jap shpjegime teknike mbi realizimin e investimeve. Keto investime janë financuar nga AKUK, ndërsa Bashkia Tepelenë ka administruar procesin e zbatimit, duke zhvilluar procedurat e prokurimit, lidhjen e kontratave me operatorët ekonomikë, mbikëqyrjen e punimeve, kolaudimin dhe procedurat e marrjes në dorëzim të objekteve, dokumentacioni i plotë për secilin investim është vënë në dispozicion të komisionit.

Këshilltari z. Ditar Hodaj; Përfaqësuesit e institucioneve përgjegjëse të raportojnë para Këshillit edhe për cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve.

Z. Spiro Kora; Projektvendimi ka të bejë vetëm me transferimin tekniko-financiar të aseteve dhe jo me administrimin e shërbimit të ujësjellësit apo me tarifat e furnizimit me ujë, investimi për rikonstruksionin e rrjetit të brendshëm të ujësjellësit në fshatrat Sinanaj, Dhemblan dhe Progonat ishte përfunduar, kolauduar dhe audituar sipas procedurave përkatëse.

Znj. Matilda Çela; Në fshatin Sinanaj ka problematika në furnizimin me ujë dhe se në dokumentacionin e paraqitur rezultonin paqartësi lidhur me fazat e financimit dhe realizimit të investimit.

z. Spiro Kora; Projekti për Sinanajn është realizuar sipas fazës së financuar, ndërsa faza të tjera të investimit janë projektuar dhe presin financim të mëtejshëm, situata është e ngjashme edhe për investimet në Peshtan dhe Mezhgoran.

Znj. Matilda Çela; Në tabelat shoqëruese të projektvendimit nuk pasqyrohej qartë ndarja sipas fazave të investimit.

Drejtori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, z. Spiro Kora; Objekti përkatës është certifikuar përfundimisht sipas procedurave të parashikuara, për tre objektet e tjera ende nuk është bërë çlirimi i garancisë së punimeve, çka tregon se procedurat përkatëse nuk kanë përfunduar plotësisht, investimet në fjalë janë financuar nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve (AKUK) dhe, pas përfundimit të procedurave të realizimit dhe certifikimit, asetet duhet t'i transferohen institucionit që do t'i administrojë dhe menaxhojë ato. Bashkia nuk ka më funksion administrues mbi këto asetet pas përfundimit të procesit të transferimit.

Fjalën e mori këshilltari z. Latif Kacaj; Për ujësjellësin e fshatit Dhemblan nuk mund të konsiderohet i përfunduar, pasi vetëm një pjesë e fshatit furnizohet me ujë, ndërsa pjesa tjetër vijon të ketë probleme me furnizimin.

Fjalën e mori Drejtori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, z. Spiro Kora; projektvendimi në shqyrtim nuk lidhet me veprimtarinë e shoqërisë së Ujësjellës-Kanalizimeve, por vetëm me transferimin e aseteve të realizuara nga Bashkia Tepelenë dhe të financuara nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve.

Fjalën e mori këshilltari z. Dino Selimi; Në mbledhjen e radhes të ftohen përfaqësues të Ujësjellës-Kanalizimeve Rajonale, si dhe përgjegjësi i Ujësjellësit Tepelenë, për të raportuar mbi tarifat e ujit dhe problematikat e shërbimit, qytetarët e Tepelenës paguajnë tarifa më të larta krahasuar me zona të tjera dhe kërkoi më shumë informacion mbi arsyet e kësaj difference, është zhvilluar një dëgjese publike në qytetin e Tepelenës nga përfaqësues të shoqërisë së ujësjellësit.

Fjalën e mori këshilltari z. Ditar Hodaj; Shqetësimin lidhur me nivelin e tarifës së ujit të pijshëm, qytetarët paguajnë fatura të larta dhe mbi cfare kriteresh që kanë sjellë diferencimin e çmimeve ndërmjet njësive të ndryshme administrative.

Fjalën e mori këshilltari z. Vladimir Bakiaj; Këshilli Bashkiak ka diskutuar çështjen e tarifave të ujit dhe kishte paraqitur propozime të ndryshme lidhur me nivelin e tyre.

Kryetari i Këshillit; Çështja e tarifave të ujit nuk ishte objekt i projektvendimit në shqyrtim dhe se Këshilli Bashkiak ishte vetëm informuar për vendimet e marra nga institucionet përgjegjëse në këtë drejtim, diskutimi të përqendrohet tek rendi i ditës projektvendimi kishte të bënte me transferimin e aseteve të financuara nga AKUK dhe të realizuara nga Bashkia Tepelenë, këto asete, pas përfundimit të procedurave përkatëse, duhet t'i transferohen subjektit përgjegjës për administrimin dhe mirëmbajtjen e tyre, pavarësisht problematikave.

Fjalën e mori këshilltari z. Vladimir Bakiaj; Miratimi i transferimit të aseteve mund të konfirmohet se ato janë marrë në dorëzim përfundimisht dhe se funksionojnë sipas parametrave të parashikuar.

Kryetari i Këshillit; Projektvendimi nuk lidhet me marrjen në dorëzim teknike të investimeve, por me transferimin e aseteve në administrimin e subjektit përgjegjës, Bashkia ka detyrimin ligjor për të kryer procedurat përkatëse të transferimit.

Fjalën e mori këshilltari z. Ditar Hodaj; Te merret në konsideratë qëndrimi i Komisionit

Kryetari i Këshillit; Komisioni është shprehur një qëndrim këshillimor, duke rekomanduar që dokumentacioni të mos miratohej në këtë fazë dhe që investimet të paraqiteshin të ndara sipas objekteve përkatëse, në mënyrë që të kishte më shumë qartësi mbi gjendjen e secilit ujësjellës, vendimmarrja i takonte Këshillit Bashkiak dhe secili këshilltar duhej të shprehte qëndrimin e tij me votë.

Fjalën e mori këshilltari z. Dino Selimi; Propozoi ngritjen e një grupi pune ose komisioni nga Këshilli Bashkiak për të verifikuar në terren realizimin e investimeve dhe gjendjen faktike të aseteve që do të transferohen.

Fjalën e mori znj. Matilda Çela; Anëtarët e komisionit po përcillnin shqetësimet e qytetarëve lidhur me mungesën e furnizimit me ujë në disa zona dhe mosvendosjen e matësve të ujit, kërkoj që grupi teknik që ka kryer marrjen në dorëzim të investimeve të paraqitet në Këshill për të dhënë sqarimet e nevojshme.

z. Spiro Kora; Nëse asetet do të vazhdonin të mbeteshin në inventarin e Bashkisë pa u transferuar, ato rrezikonin të amortizoheshin dhe të dilnin jashtë funksionit, institucioni përgjegjës për administrimin e tyre duhet t'i marrë në dorëzim për të garantuar mirëmbajtjen dhe funksionimin e tyre.

Znj. Matilda Çela; Këshilli kërkon informacion të plotë mbi investimet, veçanërisht për projektin e vendosjes së matësve të ujit në qytetin e Tepelenës dhe për situatën e furnizimit me ujë në disa fshatra, Bashkia ka të drejtën të transferojë asete, por Këshilli duhet të ketë garanci se objektet përkatëse janë përfunduar sipas projektit dhe janë funksionale.

Fjalën e mori z. Dino Selimi; Do të ishte e nevojshme prania e përgjegjësit të Ujësjellësit në mbledhje për të dhënë informacion mbi problematikat e ngritura nga banorët, përfshirë rastet kur familje të caktuara ende nuk kanë lidhur kontrata me shoqërinë e ujësjellësit.

Kryetari i Këshillit deklaroi hapjen e votimit për projektvendimin “Për transferimin e aseteve të financuara nga AKUK dhe të realizuara nga Bashkia Tepelenë”.

Vota PRO: 2 Arben Gumeni, Dino Selimi, 1 vote abstenim Mirela Varfi, 9 vota kunder. Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Besnik Maca, Marsela Balili, Matilda Çela, Latif Kacaj

Nuk miratohet.

Fjalën e mori Drejtori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, z. Spiro Kora; Dokumentacioni përkatës është vënë në dispozicion të këshilltarëve dhe se çështja në shqyrtim lidhet me aspektin financiar dhe administrativ të transferimit të aseteve, jo me vlerësimin teknik të investimeve. Ju kërkoj sqarim mbi informacionin shtesë që kërkohoni ju nga administrata.

Kryetari i Këshillit; Investimet dhe dokumentacioni përkatës duhet të paraqiten veçmas për secilin objekt, në mënyrë që Këshilli të ketë një pasqyrë më të qartë mbi gjendjen e tyre.

Fjalën e mori znj. Matilda Çela; Komisionit kërkoi që të procedohej fillimisht me ato investime që kanë përfunduar plotësisht dhe për të cilat nuk ka paqartësi lidhur me realizimin dhe funksionimin e tyre.

Këshilltari z. Ditar Hodaj; Propozoji ngritjen e një grupi pune ose komisioni verifikimi për të konstatuar në terren gjendjen e investimeve, veçanërisht për vendosjen e matësve të ujit dhe investimet në ujësjellësit e fshatrave Nivicë, Sinanaj dhe Progonat, gjithashtu zhvillimin e një mbledhjeje të jashtëzakonshme pas kryerjes së verifikimeve, me qëllim rishqyrtimin e çështjes.

Kryetari i Këshillit; Këshilli Bashkiak; Nuk po merrte në dorëzim investimet, por po shqyrtonte transferimin e tyre tek shoqëria rajonale e ujësjellës-kanalizimeve, se ngritja e komisioneve të verifikimit lidhet me rastet kur investimet merren në administrim ose në ngarkim të Bashkisë, ndërsa në këtë rast bëhej fjalë për transferimin e aseteve tek institucioni përgjegjës për administrimin e tyre.

Pika e tetë e rendit të ditës: Projektvendim: “Për dhënien e ndihmës financiare për personat e dëmtuar nga zjarri dhe përmbytjet”.

Fjalën e mori këshilltari z. Ditar Hodaj; Objektet e dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore janë të siguruara nga pronarët e tyre.

Fjalën e mori z. Pellumb Hoxha; Objektet për të cilat janë paraqitur kërkesat për ndihmë financiare nuk rezultojnë të siguruara.

Fjalën e mori z. Myzafer Lici, ekspert i jashtëm; Gjatë harkut kohor të një viti kanë ndodhur dy fatkeqësi natyrore të rëndësishme në vend, përkatësisht përmbytje dhe zjarre, të cilat kanë prekur edhe territorin e Bashkisë Tepelenë, në këtë kuadër, Këshilli i Ministrave ka miratuar aktet përkatëse që parashikojnë mundësinë e kompensimit financiar të personave të dëmtuar nga

fatkeqësitë natyrore, në përputhje me fondet dhe burimet financiare të vëna në dispozicion nga institucionet përgjegjëse.

Fjalën e mori këshilltari z. Ditar Hodaj: Për sa kohë ekziston një vendim i Këshillit të Ministrave që rregullon këtë proces, pse duhet një vendimmarrje nga Këshilli Bashkiak.

z. Pellumb Hoxha; Administrata e bashkisë ka detyrimin ligjor që kërkesat e qytetarëve për përfitimin e ndihmës financiare nga fondi i emergjencave civile t'ia paraqesë për shqyrtim dhe miratim Këshillit Bashkiak, kërkesat janë administruar sipas procedurave përkatëse, janë verifikuar nga strukturat përgjegjëse dhe janë paraqitur për vendimmarrje në Këshill.

Fjalën e mori znj. Matilda Çela; Projektvendimi është shqyrtuar paraprakisht në komision, gjatë diskutimeve kemi kërkuar plotësimin e dokumentacionit veçanërisht konfirmimin nga Policia e Shtetit për rastet e zjarreve, verifikimi në terren është kryer nga grupi i punës i ngritur nga Bashkia, në mbledhjen e komisionit të zhvilluar një ditë më parë ishte paraqitur dokumentacioni plotësues, përfshirë shkresat e Policisë së Shtetit dhe të strukturave të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (MZSH).

Fjalën e mori këshilltari z. Vladimir Bakiaj; përfituesit që zotërojnë koshere bletësh janë të regjistruar dhe të pajisur me NIPT, sipas kërkesave ligjore në fuqi.

Kryetari i Këshillit; Ngjarjet kanë ndodhur rreth një vit më parë, është e rëndësishme që dokumentacioni shoqëruar të jetë sa më i plotë, përveç procesverbaleve të MZSH-së, në dosje të përfshihet edhe konfirmimi nga Policia e Shtetit, pasi në rastet e zjarreve ndërhyjnë të dy institucionet, e rëndësishme dokumentacioni i pronësisë për rastet e dëmtimit të kulturave bujqësore dhe dosjet të përmbajnë fotografi të qarta të dëmeve në momentin e paraqitjes së kërkesës, propozoj gjithashtu që në komisionet e verifikimit të përfshihen edhe përfaqësues të Këshillit Bashkiak.

Fjalën e mori sërish z. Vladimir Bakiaj; Ka dokumente apo kërkesa të tjera që nuk janë paraqitur për shqyrtim?

Pellumb Hoxha; Të gjitha kërkesat e qytetarëve janë administruar përmes platformës e-Albania dhe se nuk ka asnjë kërkesë të pashqyrtuar nga Bashkia për rastet e përmytjeve dhe zjarreve, të gjitha aplikimet janë verifikuar dhe trajtuar sipas procedurave përkatëse.

Kryetari i Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projekvendimeve të cilat janë të ndara, përndim për përmytjet, përndim për zjarret.

Hidhen në votim të dy përndimet

Vota PRO: 12 Arben Gumëni, Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Besnik Maca, Marsela Balili, Matilda Çela, Latif Kacaj

Vota kundër: S'ka

Vota abstenim: S'ka

Kryetari i Këshillit; Kërkesa ankesat e depozituara pranë Këshillit Bashkiak.

Kërkesa e Shkollës 9-vjeçare “Avni Rustemi”, Tepelenë, për vendosjen e emrit “Alvens Rama”, kalçetos të qytetit të Tepelenës, në nderim të tij pas ndarjes së parakohshme nga jeta. Këshilli Bashkiak vlerësoi kërkesën dhe ra dakord që ajo t’i përcillet Bashkisë Tepelenë për shqyrtim dhe përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për paraqitjen e një projektvendimi.

Kërkesa e z. Mysteak Bega, banor i fshatit Hormovë, Njësia Administrative Qendër, i cili kërkon mbështetje financiare për rikonstruksionin e banesës së tij. Këshilli vendosi që kërkesa t’i përcillet zyrës përkatëse në Bashki për verifikim dhe shqyrtim.

Kërkesa e z. Dritan Mustafaraj, banor i qytetit të Tepelenës dhe administrator i një aktiviteti biznesi në qytet, i cili kërkon vendosjen e sinjalistikës së përshtatshme rrugore dhe orientuese. Këshilli vendosi që kërkesa t’i përcillet strukturave përgjegjëse të Bashkisë për shqyrtim dhe vlerësim.

Kërkesa e znj. Refie Nanaj, banuese në Bashkinë Tepelenë, e cila kërkon izolimin e korridorit të katit të pestë të pallatit ku banon. Këshilli vendosi që kërkesa t’i delegohet zyrës përkatëse në Bashki për shqyrtim.

Kërkesa e znj. Nertila Xhebra e cila kërkon ndihmë financiare për arsye shëndetësore. Këshilli vendosi që kërkesa t’i përcillet strukturave përgjegjëse të Bashkisë për verifikim dhe trajtim sipas legjislacionit në fuqi.

Kërkesa e z. Sadik Varfi, banor i fshatit Dukaj, Njësia Administrative Qendër, i cili kërkon ndihmë financiare për arsye shëndetësore. Këshilli vendosi që kërkesa t’i përcillet zyrës përkatëse në Bashki për shqyrtim.

Kryetari i keshillit; Projekt vendim “Për shfuqizimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 11, datë 29.01.2026, “Për caktimin e masës së shpërblimit shtesë për Kryetarin e Këshillit Bashkiak Tepelenë”.

Shfuqizimin e këtij vendimi, pasi nga ana e këshilltarëve propozues nuk është paraqitur në kohën e duhur relacioni shoqërues argumentues, i cili përbën dokumentacion të domosdoshëm për shqyrtimin dhe miratimin e aktit. Për këtë arsye propozohet shfuqizimi i vendimit dhe paraqitja për shqyrtim e miratim e një projektvendimi të ri, të shoqëruar me të gjithë dokumentacionin përkatës. Ta hodhim në votim propozimi për shfuqizimin e Vendimit nr. 11, datë 29.01.2026, “Për caktimin e masës së shpërblimit shtesë për Kryetarin e Këshillit Bashkiak Tepelenë”.

Vota PRO: 12 Arben Gumeni, Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Besnik Maça, Marsela Balili, Matilda Çela, Latif Kacaj

Vota kundër: S’ka

Vota abstenim: S’ka

Fjalën e mori z. Ilir Haska, i cili propozoi që, pas shfuqizimit të vendimit, të shqyrtohet dhe miratohet një projektvendim i ri, i shoqëruar me relacionin argumentues dhe dokumentacionin përkatës.

Propozimi u hodh në votim.

Vota PRO: 12 Arben Gumeni, Mirela Varfi, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Besnik Maça, Marsela Balili, Matilda Çela, Latif Kacaj.

Vota kundër: S'ka

Vota abstenim: S'ka

Mbyllet mbledhja e këshillit ora 13.15

SEKRETARE E KËSHILLIT

Valbona ÇELA



KRYETARI I KËSHILLIT

Arben GUMENI













REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

LISTË-PREZENCA E KËSHILLTARËVE
MBLEDHJA E KËSHILLIT BASHKIAK TEPELENË
Datë: 28.05.2026

Në mbledhjen e zhvilluar më datë 28.05.2026 morën pjesë këshilltarët si më poshtë:

Nr	Emër Mbiemër	Neneshkrimi
1	ARBEN GUMENI	
2	MATILDA ÇELA	
3	DINO DELIMI	
4	MIRELA VARFI	
5	MJAFTONI ZERAJ	
6	ESMERALDA BISHANI	
	BESNIK MAÇA	
8	LATIF KAÇAJ	
9	MIFTAR META	
10	ILIR HASKA	
11	MARSELA BALILI	
12	MARIOS JORGO	
13	DITAR HODAJ	
14	VLADIMIR BAKIAJ	
15	VLADIMIR GJONÇA	